

VENDIM
Nr.448, datë 16.6.2010

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.27, DATË 19.1.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË VLERËSIMIT DHE TË
DHËNIES SË KONCESIONEVE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 5 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Në vendimin nr.27, datë 19.1.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

Pas paragrafit të tretë, të shkronjës “a” të pikës 2 të kreut V “Udhëzime për mënyrën e zbatimit të procedurave konkurruese”, shtohen paragrafët me këtë përmbajtje:

“- Autoriteti kontraktor, në bazë të një vlerësimi, mund të japë një afat deri në 12 muaj, për kontratat e ndërtimit të hidrocentraleve me koncesion me kapacitet deri 5 MW, deri në 18 muaj, për kontratat e ndërtimit të hidrocentraleve me koncension me kapacitet nga 5 deri 20 MW dhe deri në 24 muaj, për kontratat e ndërtimit të hidrocentraleve me koncesion mbi 20 MW, për marrje lejeje dhe përgatitje projekti.

- Të gjitha shoqëritë koncesionare, të cilat, deri në hyrjen në fuqi të këtij vendimi, nuk e kanë parashikuar afatin e nevojshëm të marrjes së këtyre lejeve në kontratat koncesionare përkatëse, kanë të drejtë ta shtyjnë afatin sipas përcaktimeve të paragrafit të mësipërm, nga data e hyrjes në fuqi të kontratës.

- Shtyrja e afatit të pasqyrohet, për çdo rast, në kontratat shtesë të palëve në koncesion. Ministri përgjegjës i miraton këto kontrata, të cilat hyjnë në fuqi me firmosjen e saj nga palët.”.

2.Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nxjerr udhëzimin për të përcaktuar afatet konkrete, brenda afateve të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, për çdo hidrocentral.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha